



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0170

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Albimi LTD SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të Policia e Kosoves në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me skuter elektrik me bateri rimbushese dhe biçikleta elektrike me bateri rimbushese me numër të prokurimit 214-24-11421-1-1-1, me 03/06/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërishte e bazuar ankesa e OE Albimi LTD SH.P.K. me nr. 2025/0170 , e datës 07/03/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me skuter elektrik me bateri rimbushese dhe biçikleta elektrike me bateri rimbushese me numër të prokurimit 214-24-11421-1-1-1.
2. Mbetë në fuqi njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit për pjesën 2, sipas dispozitivit I të këtij vendimi.
3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 08/11/2024, Policia e Kosoves në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Furnizim me skuter elektrik me bateri rimbushese dhe biçikleta elektrike me bateri rimbushese me numër të prokurimit 214-24-11421-1-1-1.

Ndërsa me datën 19/02/2025 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 420,000.00 €

Me 23/02.2025, OE Albimi LTD SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 27/02/2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04/04/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Albimi LTD SH.P.K. me nr. 0170/2025 lidhur me aktivitetin Furnizim me skuter elektrik me bateri rimbushese dhe biçikleta elektrike me bateri rimbusheseme numër të prokurimit 214-24-11421-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Albimi LTD SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendim Ankimor në lidhje me Eliminimin nga Procedura e Prokurimit

Ne, si operator ekonomik, vlerësojmë se arsyet e dhëna për eliminimin tonë nga kjo procedurë prokurimi nuk qëndrojnë, pasi kemi përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Këto pretendime i kemi paraqitur edhe në kërkesën për rishqyrtim.

Në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, kemi ofruar biçikleta që i përmbushin të gjitha kushtet dhe kërkesat e dokumenteve të tenderit:

- Kemi dorëzuar Certifikatën e Baterisë, e cila është në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.
- Kemi ofruar Deklaratën e Konformitetit, që konfirmon se biçikletat përmbushin standardet e BE-së dhe mund të përdoren në tregun evropian.

Duke qenë se produkti final përbëhet nga pjesë të certifikuara sipas standardeve të BE-së, kjo tregon qartë se edhe produkti final i përmbush këto standarde. Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar ndonjë certifikim të veçantë për produktin final, por vetëm që të jetë në përputhje me standardet evropiane.

Sipas praktikave që i ndjekim me klientët tanë në eksport, ne i prodhojmë biçikletat sipas standardeve evropiane dhe i pajisim me Deklaratë të Konformitetit. Në rastet kur ndonjë klient ka dyshime shtesë, ai ka të drejtë të kërkojë certifikim përfundimtar të produktit, me kosto që e bart vetë. Biçikleta si njësi nuk kërkon certifikim shtesë, pasi vërtetimi përputhshmërisë bazohet në certifikimin e pjesëve përbërëse.

Ne kemi ofruar dokumentacion të plotë dhe të saktë sipas kërkesave të tenderit. Në përputhje me praktikat e prokurimit publik dhe rregulloret e BE-së, përdorimi i pjesëve të certifikuara është i mjaftueshëm për të garantuar përputhshmërinë me standardet.

Refuzimi i ofertës sonë nuk është i bazuar në një vlerësim të drejtë të dokumentacionit të dorëzuar.

Bazuar në përshkrimin e mësipërm, konstatojmë se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), si më poshtë:

Pretendimi Ankimor 1 – Neni 1: Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike, duke përcaktuar kushtet, rregullat, procedurat dhe të drejtat që duhet të respektohen nga të gjitha palët e përfshira në aktivitetet e prokurimit publik.

AK - Policia e Kosovës, duke eliminuar ofertën tonë si të papërgjegjshme, edhe pse ishte dukshëm më e lirë dhe në harmoni me çmimet e tregut, ka shkelur nenin 1 të LPP-së.

Pretendimi Ankimor 2 – Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Autoritetet kontraktuese janë të obliguara të sigurojnë përdorimin sa më ekonomik të fondeve publike, duke marrë parasysh qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Eliminimi i ofertës sonë me çmim më të ulët tregon se AK nuk ka respektuar këtë nen, duke mos e shfrytëzuar buxhetin në mënyrën më ekonomike.

Pretendimi Ankimor 3 – Neni 7: Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi

Autoriteti kontraktues është i detyruar të trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe të veprojë me transparencë.

Eliminimi i ofertës sonë, edhe pse ishte ofertë e përgjegjshme dhe me çmim më të ulët, tregon qartë një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues nga AK ndaj nesh si operator ekonomik.

Pretendimi Ankimor 4 – Neni 59: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Sipas nenit 59, paragrafi 4 i LPP-së, një tender konsiderohet i përgjegjshëm nëse është në përputhje me kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit. Edhe në rastet e gabimeve ose paqartësive të vogla, tenderi mund të jetë i pranueshëm nëse ato nuk ndryshojnë aspektet

materiale të ofertës.

Me datë 31.01.2025, AK - Policia e Kosovës ka kërkuar sqarime shitesë përmes letrës standarde, ku ndër të tjera kërkonte:

1. Certifikatën për baterinë (36V 20Ah 720Wh), të integruar në trupin e biçikletës, me certifikatë sipas ANEKSIT 1.
2. Deklarimin se biçikleta elektrike me bateri rimbushëse përdoret në BE, në përputhje me specifikimet teknike.

Me datë 05.02.2025, ne kemi dërguar sqarimet e kërkuara, duke bashkangjitur dokumentin UN38.3 TEST REPORT, i cili dëshmon përputhshmërinë sipas kërkesave të AK-së. Ky dokument është pjesë përbërëse e kësaj ankese.

Përkundër ofrimit të këtij dokumenti, me datë 14.02.2025, AK na ka njoftuar me Letrën Standarde për eliminimin, duke pretenduar se nuk kemi dëshmuar përputhshmërinë e biçikletës me standardet evropiane.

Kjo tregon qartë se kërkesa për sqarime është bërë vetëm për t'u arsyetuar, ndërsa dëshmitë tona nuk janë marrë parasysh.

Për më tepër, bazuar në sa më sipër, AK - Policia e Kosovës ka bërë shkelje edhe të këtyre dispozitave të LPP-së:

Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 62 – Procedura për Marrjen e Vendimit për Dhënie të Kontratës

Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 72 – Dokumentacioni dhe Informacioni Shtesë

Në përfundim, kërkojmë nga organi kompetent që të marrë në shqyrtim këto shkelje dhe të bëjë rivlerësimin e ofertës sonë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, në përputhje me parimet dhe dispozitat e LPP-së.

Përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim: Operatori Ekonomik “ALBIMI LTD” Sh.p.k., si palë e pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK), ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për vendim mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull:

“Furnizim me skuter elektrik me bateri të rimbushshme dhe biçikleta elektrike me bateri të rimbushshme” – Pjesa 2, me numër të prokurimit 214-24-11421-1-1-1 & 21424/163/111, duke pretenduar se janë bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), konkretisht Ligjit nr. 04/L-042, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Pretendimet ankimore të OE “ALBIMI LTD” Sh.p.k.

Operatori Ekonomik pretendon se AK ka bërë shkelje të:

Nenit 59 të LPP-së

Nenit 67 të LPP-së

Përgjigjja e Autoritetit Kontraktues ndaj pretendimeve:

1. Në lidhje me pretendimin për shkelje të Nenit 59 të LPP-së:

AK nuk ka bërë shkelje të Nenit 59. Autoriteti Kontraktues ka konsideruar një ofertë si të përgjegjshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë, FDT-në dhe specifikimet teknike të detyrueshme (Aneksi 1).

AK ka kryer ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e të gjitha ofertave në mënyrë të barabartë, jo-diskriminuese dhe në përputhje të plotë me dokumentet e tenderit. Prandaj, ky pretendim i OE-së është i pabazuar.

Sipas Aneksit 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme, janë përshkruar karakteristikat e domosdoshme të objektit të kontratës, si: kualiteti, performanca, dizajni, testimi, paketimi, etj.

Ndër të tjera, në këtë aneks thuhet:

“Obligative: Biçikletat elektrike me rimbushje duhet të jenë sipas standardeve evropiane që përdoren në BE. Viti i prodhimit duhet të jetë aktual me urdhër-blejjen. Ofertuesit duhet të paraqesin katalogun e biçikletës.”

OE, edhe pas sqarimeve, nuk ka arritur të dëshmojë se biçikletat e ofruara janë prodhuar sipas standardeve evropiane të aplikueshme në BE. Po ashtu, nuk është paraqitur asnjë direktivë e BE-së që vërteton se produkti është në përputhje me kërkesat teknike të parashtruara nga AK.

Për këtë arsye, oferta e OE-së konsiderohet e papërgjegjshme dhe pretendimi është i pabazuar.

2. Në lidhje me pretendimin për shkelje të Nenit 67 të LPP-së (Provat shkresore):

AK sqaron se nuk qëndron pretendimi për shkelje të këtij neni, sepse OE ka dorëzuar një Deklaratë të Konformitetit të lëshuar nga vetë operatori, e cila nuk përmban asnjë referencë ndaj standardeve të BE-së, që do të vërtetonte përputhshmërinë e biçikletave me kërkesat përkatëse.

Më poshtë është përmbajtja e Deklaratës së Konformitetit, e dorëzuar nga OE:

Deklaratë e Konformitetit

Lëshuar nga: ALBIMI LTD Sh.p.k.

Data: 04.02.2025

Adresa: Rr. Lidhja e Prizrenit, Gjilan

Produkti: Biçikletë elektrike me bateri të rimbushshme – Pllot Police

“Ne deklarojmë me përgjegjësi të plotë se produkti i lartpërmendur është prodhuar duke përdorur komponentë të importuar nga furnizues të certifikuar dhe përputhet me kërkesat e tregut të Bashkimit Evropian.”

Deklarata është lëshuar me përgjegjësi të plotë ligjore dhe është e vlefshme për të gjitha efektet e tenderit.

Kjo deklaratë, megjithatë, nuk vërteton përputhshmërinë me ndonjë standard të caktuar të BE-së dhe nuk ka asnjë dokument mbështetës si direktiva apo standarde të harmonizuara të BE-së që kërkojnë sipas Aneksit 1.

OE ka pretenduar gjithashtu se ka dorëzuar një certifikatë për baterinë sipas standardeve evropiane. AK sqaron se është dorëzuar vetëm raporti i testimit UN38.3 – Rechargeable Li-ion Battery – DZ-ZZ2091004, që i referohet vetëm artikullit 8 të specifikimeve teknike, ku është kërkuar certifikatë për baterinë.

Ky dokument nuk mbulon gjithë produktin (biçikletën elektrike) dhe për këtë arsye nuk mjafton për të konsideruar ofertën si të përgjegjshme.

Specifikimi teknik për artikullin 8:

Bateria e integruar në trupin e biçikletës: 36V 20Ah 720Wh – me certifikatë. Minimumi i kapacitetit të baterisë duhet të jetë në këtë amperazh.

Në përputhje me nenin 108/A, paragrafi 10.1 të LPP-së, Policia e Kosovës refuzon kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 21/03/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0170/2025, ndërsa me datë 29/04/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0170/2025, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit për pjesën 2 dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Albimi LTD SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0170 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i pare (I), Pretendimi kryesor sipas ankesës 170/25 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE në këtë rast ankues, ku sipas AK-së OE edhe pas sqarimit nuk ka arritur të dëshmojë se prodhuesi është sipas standardeve evropiane që përdoren në BE.

OE ankues pretendon se ky arsyetim i AK-së është i pabazuar, pasi me dosje të tenderit nuk është kërkuar ndonjë certifikim apo ndonjë standard konkret për këtë kërkesë.

Përveç kësaj, OE ankues pretendon se si prodhues i biçikletave ka ofruar deklaratë të konformitetit se produktet që ofron janë në pajtim me Rregullat e BE-së, e po ashtu ka ofruar certifikatë për bateri, në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

Pas analizimit të ankesës dhe pretendimeve ankimore, dosjes së tenderit FDT-së de specifikave teknike, si dhe vendimit të AK-së në kërkesë për rishqyrtim japim sqarimet si në vijim.

Pas analizimit të dosjes, sa i përket kërkesës që biçikleta duhet të jetë në pajtim me standardet evropiane që përdoren në BE, përveç se kjo kërkesë nuk është paraqitur në FDT si kërkesë kualifikuese por është paraqitur në fund të specifikimit teknik, AK më tutje nuk ka përcaktuar se me çfarë dëshmie dokumentare mund të plotësohet kjo kërkesë, e po ashtu nuk ka përcaktuar ndonjë standard konkret i cili duhet të plotësohet.

Ne kemi hulumtuar se cilat janë ato rregulla që eventualisht aplikohen në BE sa i përket biçikletave rimbushëse (elektrike), dhe kemi gjetur se dy rregullat/kufizimet kryesore janë që fuqia e motorit elektrik të mos jetë më e madhe se 250W, dhe se asistenca e motorit elektrik nuk duhet të kalojë shpejtësinë 25km/h.

Nga shkresat e lëndës nuk kemi gjetur ndonjë dëshmi apo pretendim të AK-së përmes të cilit AK ka kontestuar fuqinë e motorit elektrik, shpejtësinë, apo mos plotësimin e çfarëdo elementi/specifikimi teknik.

Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësimi ekspertit është se deklarata e konformitetit nga prodhuesi i biçikletave është në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, pasi nga AK nuk është kërkuar asnjë dokument/dëshmi dokumentare konkrete të cilën OE ankues nuk e plotëson, dhe kjo sipas neve paraqet shkelje të nenit 7, par.6, pika (v) të LPP-së : që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me skuter elektrik me bateri rimbushëse dhe biçikleta elektrike me bateri rimbushëse me numër të prokurimit 214-24-11421-1-1-1. Paneli

vëren qe në këtë ankes ka stërzgjatje të afateve kohore duke filluar nga data e ankesës 11/03/2025, autorizimi i ekspertit shqyrtues i dates: 21/03/2025 dhe dorezimi i raportit të ekspertit shqyrtues 29/04/2025 duke u tejkaluar të gjitha afatet ligjore sikurse parashihen me nenin 111 , 113 dhe 114 i LPP-së .

Paneli shqyrtuespas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës njoftimin nga AK-ja konsideron qe kjo procedur duhet të anulohet në munges të validiteti dhe sigurimit të ofertave ku sipas sistemit të e-prokurimit për këtë për çka AK-ja me datën 12.03.2025, sipas shkresës ka kërkuar tek OE-të zgjatjen e validitetit dhe sigurimit të ofertave sikurse parashihet ne nenin 30 par 30.4 , 30.5 dhe 30.6 I RrPP- së, si dhe neni 57 i LPP-së .

Paneli Shqyrtues aprovon ankesën si pjeserishte të bazuar duke mare në konsiderat Neni 30 të Rrpp-së çartëson citoj “ . 30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit) 30.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre. 30.6 Është e hapur për secilin OE të vendos nëse dëshiron të zgjatë validitetin e tenderit. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si “të papërgjegjshëm” dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre” e që në rastin konkret mungon validiteti i ofertave për çka edhe interpretimi i KRPP-se citohet “ Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës”, dhe se nuk ka mundesi kthimi retroaktiv, përderisa nuk kan ofertat validitet (mungon validiteti i ofertave). Ndërtjerash, Paneli Shqyrtues vlerëson se OE-te pjesmarres qe marin pjesë në procedura të prokurimit kan njohuri dhe përvoja të mjaftueshme në procedurat e prokurimit dhe duhet të jenë të vëmendshëm si në rastin konkret kur kemi të bëjmë me validitetin e ofertave.

Rrjedhimishtë, Paneli Shqyrtues në munges të validiteti dhe sigurimit të ofertave ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me skuter elektrik me bateri rimbushese dhe biçikleta elektrike me bateri rimbushese”, me numër të prokurimit 214-24-11421-1-1-1, që të mbetet në fuqi B58Njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulim te aktiviteti të prokurimit .

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - "ALBIMI LTD"SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: